Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/406
Datë: 13.07.2023

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e IV te mbajtur me datë 13.07.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Ri-akreditohet dhe Ri-validohet** me kushte Institucioni UBT - Prishtinë, rr. Lagjja KALABRIA p. n. Republika e Kosovës për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 29.10.2023 deri me 28.10.2026 me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 Shitja dhe shërbim i klientit, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 14 kredi të AAP. Kolegji UBT për këtë profil mund të realizojë procesin mësimor me jo më shumë se 10 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup duhet të jetë 20 kandidatë.

   1.2 Gjuhë gjermane, niveli A1 deri C1, Kolegji UBT për këtë profil mund të realizojë procesin mësimorë me jo më shume se 20 grupe ne vite, ndërsa numri i kandidatëve për grup duhet të jete 15 kandidatë.

2. Ri-akreditimi dhe Ri-validimi i institucioni është aprovuar me kushtet si në vijim:

   2.1 Ri-akreditimi dhe Ri-validimi i institucionit vlen nen kushtet e dhëna të ekipit të eksperteve të cilat janë pasqyruar ne raportin e akreditimit dhe validimit lidhur me plotësimin e kushteve.

2.2 AKK gjatë procesit të monitorimit i vlerëson dëshmitë e dhëna nga Institucioni UBT sipas afateve të aprovuara në raporte të akreditimit dhe validimit dhe raporton në KD AKK.

3. **Ri-akreditohet dhe Ri-validohet** Institucioni UBT - Prishtinë, rr. Lagjja KALABRIA p. n. Republika e Kosovës për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 29.10.2023 deri më 28.10.2026 me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   3.1 Instalues elektrik, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 19 kredi të AAP. Kolegji UBT për këtë profil mund të realizoje procesin mësimor me jo me shume se 5 grupe ne vit, ndërsa numri i kandidateve për grup duhet të jete 10 kandidatë.

4. **Akreditohet dhe validohet** Institucioni UBT - Prishtinë, rr. Lagjja KALABRIA p.n. Republika e Kosovës për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2023 deri 31.08.2026, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   4.1.Teknologji informative dhe elektronik, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në standard ndërkombëtar dhe Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për një vit kalendarik në total 3 paralele/klasa brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për 1 grup mund të jetë maksimalisht 24 kandidatë, për një cikël mësimi.

   4.2. Teknik i Optikes, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për një vit kalendarik në total 2 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për 1 grup mund të jetë maksimalisht 25 nxënës/kandidatë, për një cikël mësimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Institucionit UBT Prishtinë, Lagjja KALABRIA për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit UBT - Prishtinë
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK